

Intervistë me Jeta Xharra

Prishtinë

Kohëzgjatja: 48 minuta

Të pranishëm:

1. Jeta Xharra (E intervistuar)
2. Noa Nikqi (Intervistuesja)

Jeta Xharra: Jam Jeta Xharra, kom lindë n'Prishtinë – n'fakt, kom lindë n'Shkup, jom rritë në Prishtinë. Kom lindë në Shkup me 2 mars 1978, edhe kom shku n'shkolle fillore, e cila sot quhet "Faik Konica". Atëherë është qujtë "Aca Marović", n'qendër t'Prishtinës. Edhe mandej kom shku n'shkolle t'mesme, "Xhevdet Dode". Masnej jom regjistru n'dramaturgji, në Fakultetin e Arteve n'Prishtinë. Tri vjet kom studiu këtu, mandej kom shku n'Angli edhe e kom regjistru magjistraturën në studime të luftës në King's College, edhe studime t'skenarit t'filmit. Ka qenë magjistratura e dytë që e kom kry n'2003ten.

Kur e kom n'2003ten kry magjistraturën e dytë, si studente e dallume, jom kthy edhe e kom themelu emisionin "Jeta n'Kosovë", i cili ka fillu ma s'pari n'2005 si pjesë e organizatës që e kom themelu – Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese. Jom bashkëthemeluese e rrjetit rajonal dhe themeluese e këtij rrjeti për gazetari hulumtuese n'Kosovë, që ka nisë punën n'2005 edhe ka nisë me 3 veta – sot jemi 70 veta.

N'njëkohë, kom punu- domethonë, karrierën si gazetarë e kom fillu n'mes t'viteve '90, duke shkru për gazeta rinore, edhe mandej si producente lokale- përkthyes së pari, mandej producente lokale e BBC-së, edhe udhëheqëse e byrosë së BBC-së kur u hap zyra me fillimin e luftës, në mars '98.

Noa Nikqi: Me u kthy pak n'të '90-tat, ku ja ka nisë interesimi i juaj për gazetari?

Jeta Xharra: Interesimi ka fillu ma së pari, ndoshta me recitim se sa me gazetari. Kanë qenë n'modë, me thanë, kshu garat për recitim, edhe letërsia më ka interesu gjithmonë. Edhe obsesionin ma t'madh e kom pasë me "Poemën e Mjerimit" te Migjenit, për shembull, të cilën e kom mësua – i ka dikun 100 rreshta – edhe e kom mësua përmendsh me ndihmën e prindve, me shtytjen e prindve. Vija prej ni veni ku ka pasë gara t'recitimit, qashtu qysh sot mundet me pasë gara n'social media a diçka qashtu me thanë – ka qenë n'modë, edhe kom marrë pjesë n'gara t'recitimit. Pse po thom që qaty ka nisë gazetaria – se ka nisë interesimi jem për letërsi shumë herët, mandej me fillu me shkrujtë edhe me u marrë me shkrime. Kom botu në gazetata rinore, n'atë kohë në gazetën "Shpresa", e cila dilke si gazetë e botume prej kishës katolike që ishte ma afër lagjes teme. Kisha katolike n'vitet '90 ka qenë ni vend ku na mujsim me shku në kurse t'vallzimit, n'kurse t'gazetarisë, kurse t'dizajnit. Edhe aty jom taku me disa njerëz që bojshin dizajn t'gazetës, bojshin redaktim, edhe kemi fillu me e botu gazetën "Shpresa" n'94-5.

Shkrimet e para i kom bo për modë – isha e interesume në dizajn t'modës edhe i shkrujsha. Mandej isha e interesume në teatër – n'shkrime, siç thash, n'shkrime për teatër – edhe bojsha kritikë letrare,

shkojsa me kqyrë shfaqje. Ato i kom botu në gazetën “Eritrea”. Ajo ishte në grup tjetër i vajzave ku mësojshim në kurs të gazetarisë, edhe e botojshin gazetën “Eritrea” si pjesë e Media Projektit, që e udhëheqshin disa gra – gazetarë në atë kohë – që e majshin gazetarinë, në fakt, ishin Aferdita Kelmendi edhe Gjeraqina Vula.

Edhe qeshtu kemi fillu me kurse t'gazetarisë – në “Shpresë” botimet e para, në “Eritre”, mandej edhe te gazeta “Post-Pesimistat”, që u pat bo ni shtojcë e “Kohës Ditore”. Se dilke n'atë kohë – ma së pari “Koha Javore” ka qenë – ishin pjesë e “Kohës Javore”, mandej fillon gazetë ditore. Derisa n'98-ën vjen BBC-ja dhe kërkon gazetarë t'ri që dinë anglisht edhe dojnë me dalë n'terren, edhe me dalë n'front t'luftës. Dita jeme e parë ka qenë 6 marsi '98 – që është ditë historike, se dita e parë e punës n'BBC ka qenë si përkthyes në Prekaz, kur kemi shku me ekipin e BBC-së, ma saktësisht me Vaughan Smith, kameraman, dhe Paul Wood, gazetari i BBC-së. Shkojmë n'Prekaz, e përcjellim tymin, i gjejmë luftime tu ndodhë, tenkat e serbëve tu gjujtë neper- n'shpine e Jasharëve.

Mas tri dite e kuptojmë që si rezultat i qasaj beteje kishin dekë pesëdhjetë njerëz. Shkojmë dhe i shohim kufomat, po. Me randsi është që me qat ditë t'parë i marrim xhirimet ekskluzive, të cilat mbërrijnë qat natë n'BBC, n'edicionin e lajmeve që u qujke *Nine O'Clock News*, edhe bojnë bum. Edhe me atë natë, me ato pamje të shpijave tu u kallë të Jasharëve – n'atë moment nuk kemi pa kërkon gjallë, se shpiat veç ishin t'rrënume, tu u kallë, tu u gjujtë – fillon krejt bota me marrë vesh çka është tu ndodhë në Kosovë, dhe fillojmë me i çu gazetarë tjerë në Kosovë.

Prej qatij xhirimi fillojnë shumë gazetarë tjerë me ardhë në Kosovë. Edhe gazetari me të cilin punoj qat ditë shkon gjys kilometri ma përpara se unë, edhe gazetari – domethonë kameramani Vaughan Smith – shkon përpara tu e xhiru. Ishte masdite, ora katër, tu e bo xhirimin e famshëm tash. Ishte n'përdim t'diellit, kështu me thanë masdite, që nënkuptojke që dielli ish në atë anë dhe i reflekton – ish kundrejt kamerës së tij – i reflekton n'kamerë. Serbët e shohin edhe e gjujnë me snajper. Ai bjen n'tokë, edhe sot e dimë prej xhirimeve – të cilat tash i kom shpëtu, se mas 25 vjetve jom tu u marrë me digjitalizimin e këtyne xhirimeve – edhe bjen n'tokë, vjen tu ngajtë, gjys' kilometri larg prej ku ishim tu e pritë me makinë unë edhe gazetari Paul Wood, edhe thotë: “Diçka m'ka rrokë.” E prek barkun, kqyr a po del gjak. Tha: “Kqyrni se unë s'po e vrej, a po del dikun gjak.” E qelë maicën – vetem ni shenjë e vjollcë n'bark.

E kuptojme që plumi i tij ka hi nëpër një rryçantë që e ka pasë, e ka shpu pakon e cigares, e ka shpu pakon e pareve dhe ka përfundu në telefonin mobil – që n'atë kohë, viti 1998, ishin telefona shumë t'trashë, si toki-voki t'trashë. Edhe kishte përfundu telefoni në baterinë e mobillit dhe kish shpëtu gazetari prej këtij plumi, tu i falënderu telefonit. Kur kthehet në Angli, ai bëhet reklamues i Sonit Eriksonit! Sepse, kjo ka qenë marka e telefonit dhe del në reklamë “Sony can save your life.” Qekjo është historia e ditës së parë të punës.

Kjo përvojë, domethonë, ma shtin mu virusin e gazetarisë definitivisht – edhe pse me shkrime e kom pasë deri atëherë – por në atë moment unë e kuptoj çka është fuqia e pamjes, e atij xhirimi. Ma së pari, fuqia e sakrificës që duhesh me tejkalu për me mb'rrri deri te një pamje që ka me ndrru histori. Mendoj që ka ndrru histori, sepse prej asaj dite mediat ndërkombëtare në mënyrë konstante kanë raportu për Kosovën. Edhe veç një vjet pas ka ndodh qajo që thojke Vaughan-i atë ditë: “Ka me ndodhë shumë të vramë këtu, po nëse ne i kemi kamerat në çdo vend ku ndodhin – kamerat dhe na jemi prezentë – çdo shtëpi e kallun, çdo refugjat që qitet prej shtëpisë, çdo viktimë e Millosheviqit... kjo nuk ka me shku larg, derisa bota ka me intervenu.”

Sepse prej fillimit, gazetarët e huaj na bindshin neve – të cilët ishim... kishim kalu tetë vjet n’shkolla-shpija – që botes s’ja kish ni për neve. Domethonë, na tetë vjet ishim indoktrinu me idenë që ndoshta pse po e zhvillojmë një rezistencë paqësore, bota ka me e penalizu Millosheviqin për çka po na bon neve. Edhe na po mahemi stoikisht me këtë rezistencë paqësore – po ky durim e kish kalu afatin. Edhe na si të ri ishim shumë të frustrum që kurrë s’ka me na ndihmu Perëndimi për me u çliru.

Kur erdhën gazetarët e huaj, thanë: “Eh, qito pamje tash e ndrojnë muhabetin. S’jeni mo veç tu bo rezistencë paqësore, po tash jemi në lajmet e mbramjes – çdo natë.” Prej asaj dite tri herë n’javë kemi qenë në lajme qendrore të Anglisë. A e din çka domethanë kjo? Se krejt bota ka pasë shumë gjana tu ndodhë n’atë kohë – kane qenë edhe vrasje tu ndodhë në Somali – po nuk kanë pasë lajmërim çdo natë.

Për shkak që ishim n’Evropë, për shkak të përkushtimit të këtyne gazetarëve që ishin n’gjendje me bo shumë për me mb’rri qatë pamje – edhe pjesërisht për shkak të përkushtimit tonë, me vazhdu me i çu ata atje. Sepse u lodhëm me rezistencë paqësore, ishim të bindun që qashtu po kontribojmë, që bota me pa çka po ndodhë – me shpresë që bota lëviz diçka nëse e sheh çka po ndodhë n’Kosovë.

Është rrallë që ndodh qajo që na kena shpresu që ka me ndodhë. Po thom tash “rrallë” se po i bjen njëzet e shtatë vjet pas, kemi pase luftë n’Siri, kemi pasë luftë n’Ukrainë, kemi pasë luftë n’Afganistan, dhe së fundmi kemi pasë luftë n’Gazë. Në asnjë moment bota s’u çu me intervenu, me bo intervenim humanitar, me forca t’veta, me bombardu qate qe eshte tu bo krime qysh janë bo n’Kosovë. Domethonë, vlera e qasaj është tu u shtu secilën herë e ma shumë – edhe 25 vjet mas – pikërisht për shkak se po mendoj që ka qenë shumë e rëndësishme çka u bo në të ’90tat.

Kom vendosë me kalu kohë tu i mbledh arkivat e materialeve që i kemi xhiru viteve ’90, arkiva t’cilat kurrë s’janë digjitalizu. Edhe e kom bind Vaughan Smithin, kadal-kadal, me na i dhanë arkivat e veta – dy vjet ka xhiru n’Kosovë. Jo vetëm Vaughanin, por edhe shumë gazetarë t’BBC-se me të cilët kom punu: Nik Millar, David Lloyd, Ben Brown, Jon, Jeremy Bowen – janë paraqitë vullnetarë me na i dhanë reportazhet që i kanë xhiru atëherë. Kanë qenë krejt kaseta të mëdhaja, në BETA Cam – BETA Cam janë qikaq të mëdhaja, s’janë domethonë çip qysh është sot – kamerat kanë qenë shumë t’mëdhaja. Edhe kemi fillu me i digjitalizu.

Kemi kriju me kolegë t’ri që i kom në zyrën tonë, që kanë shfaqë interesim për këto xhirime – krejt janë nër tridhjetëvjeçarë, domethonë. Kom punu, jom goxha krenare që kom pasë presion t’sh’noshë prej gjeneratave t’reja, njëzet e te nalt vjeçarë, që kanë lindë mas luftës, që kanë qenë t’interesum me ndihmu me i digjitalizu këto.

I kam njerëz si: Arian Hyseni – shef i teknikës te na, Patreon Ibrahim, osht Albulena Sadiku, Kreshnik Gashi, Visar Prebreza, Besnik Rivanieva – krejt janë qita që m’kanë ndihmu me i jetësu qito xhirime, që m’u kriju ni muze. Sot e kemi muzeun *Reporting House*, ku 30 orë materiale janë të përkthyme në dy gjuhë, të digjitalizum, edhe janë jo verem prej BBC-së, po edhe prej televizioneve tjera – si televizioni publik japonez, televizioni publik spanjoll, televizioni

publik gjerman NDR, televizioni privat japonez *Nippon TV*, *Irish Public TV* apo televizioni publik irlandez, të cilët i kanë dhanë materialet e tyre për këtë muze që sot gjindet n' mes të Prishtinës.

Noa Nikqi: Nëse kisha mujt edhe pak me u kthi tek roli juaj si fixer – çka mendoni? A mendoni që më shumë keni qenë interpretues të kulturës, e jo veç përkthyes?

Jeta Xharra: Definitivisht kemi qenë interpretues të kulturës. Edhe na, prej vogjlise, e kemi pa – prej inkuadrimin në organizata rinore. Kur ke lexu ti për historinë e gazetarisë shqiptare, e ke pa që njerëzit që e kanë bo shtetin shqiptar – mas pari, Fan Noli, Faik Konica, krejt shkrimtarët e asaj kohe – kanë bo mas pari gazetë, mandej e kanë bo shtetin tonë. Domethonë, artikulet e para, edhe rilindasit shqiptarë i kanë pasë përmes gazetarisë.

Edhe na jau kemi lexu, kur kemi mësu n'shollë për këta shkrimtarë, i kemi pa që ata kanë bo revista. Edhe çka na ka ndodhë neve, është: tu lexu për ta, na kemi bo revista. Na jemi – ju kemi bashku revistave, të cilat kanë qenë manifestim i dëshirës tonë me rujt identitetin shqiptar, shkrimin shqiptar, foljen ne shqip, mësimin ne shqip.

Domethonë, rezistenca jonë kundër Millosheviqit – në klasë t'tetë më kanë qitë, për shembull, prej shkollës fillore. Menjëherë e ke ditë që ty po t'qesin prej shkollës fillore, se nuk po pranon ti dhe familja jote dhe komuniteti dhe shoqnia jote s'po pranojnë me mësu serbisht.

Do me thanë, ma së pari gjuha ka qenë çashtje. Para se me ditë ti për shtetin e pavarun të Kosovës, ti ke luftu për me mësu në gjuhën tande. Domethonë, prej fillimit kemi qenë – manifestim, qenia jonë mos me shku n'shollë serbisht ka qenë manifestim i ruajtjes së kulturës dhe identitetit.

Shumë para se me ardhë gazetarët e huaj, e kemi kuptu që na duhet me e rujt gjuhën edhe kulturën tonë. Edhe kjo është seni i parë: gjuha dhe kultura.

Seni i dytë ka qenë me kuptu që religjioni nuk është i rëndësishëm për neve – po, ajo klisheja që “feja jonë është shqiptaria”.

Domethonë, pse po them këtë? Sepse tu e pa luftën tu ndodhë në Bosnje neve na u bo e qartë që bota po e këqyrte si luftë të myslimanëve të Bosnjës edhe serbëve të Serbisë. Populli në Bosnje u identifikojke si mysliman – na nuk u ndishim hiç myslimanë.

Kur erdhën gazetarët e huaj në Kosovë, fillun për shembull me thanë – pjesen kryesore e reportazhit që e bën gazetari kur e jep përfundimin e fjalisë se çka po ndodhë – është një 20 sekondëshi i cili quhet “para kamerë” apo “Piece to Camera”. Edhe ai është momenti, domethonë, zgjat reportazha një minutë e gjysë, kallxon me pamje tjera çka është tu ndodhë n'kët' vend – ka pamje, për shembull, prej dy anëve të konfliktit, dikush flet diçka, ka pamje t'luftës.

N'fund del gazetari para ni veni edhe thotë çka po ndodh. Gazetarët dilshin para ni vendi ose para kamerës edhe thojshin: “Çomë te xhamia. Tash çomë te xhamia” – domethonë, si përkthyes apo producent lokal, e kishe rolin me i çu te vendet që ata kërkonin. Edhe na

menjëherë fillum – unë e di që edhe shokët e shoqet e mia që punojshin si unë – fillum me u ndi jo komod. Edhe thojshim: “Pse po lypni me shku te xhamia?” Edhe thojshin: “Po, sepse kjo është luftë si në Bosnje. E kemi shku gjithmonë para xhamisë së popullatës myslimane, e po dojme me kallëzu ku jemi. Me xhaminë mbrapa, kallëzojmë që jemi në vend mysliman.”

Na u thojshim: “Po ju jeni te ni vend shqiptar. Ju s’jeni në vend mysliman. Ky vend është, ma së pari, shqiptar – e masanej tjerat.”

“Po na duhet diqysh botës me i kallëzu audiencës tonë çka jeni ju.”

Na insistojsim: “Na jena shqiptarë. Ju duheni me e kuptu çka jena na – jo me na qit labels apo me na qit tiketa që ju mendoni që na jemi. Na ju kallxojmë çka jemi.”

Domethonë, s’po thom une që qashtu i thojshim direkt, po ishin debatet tona – këmbëngulësia jonë me ua spjegu atyne, t’u i thirrë n’shtëpi, t’u jau kallxu kulturën tonë n’shtëpi, t’u ua kallxu kulturën tonë, vendet ku dilshim me pi kafe, t’u e kallxu venin, kulturën, shoqinë me të cilën jemi të rrethum’, muzikën me të cilën jemi të rrethum’.

Edhe n’fund ja nisen me e kuptu që ky nuk është njëjtë si Bosnja – që Bosnja nuk e ka pasë identitetin e vet boshnjak të definum qysh e ka pasë Kosova.

Edhe na – jo veç kemi qenë përkthyes të kulturës na kemi qene– domethonë e kemi ni edhe një detyrë me e kallxu të vërtetën në këtë aspekt. Nuk kemi qenë njerëz që mundet me na kallxu bota çka jemi – a jena myslimanë a jo. Kemi insistu na me ia kallxu botës.

Edhe është interesant që mas 25 vjetëve, kur në 25-vjetorin e përfundimit të bombardimeve – me 10 qershor 2024 – e hapëm muzeun, i ftumë këta gazetarë që kishin punu në ’90tat. Disa prej tyne 25 vjet s’kishin qenë ktu. Edhe në njonën prej intervistave, ky gazetari kryesor që e kishte bo intervistën me Fehmi Lladrovcin – ku unë e kisha përkthi – tha: “Na kena mendu që na po ju kallxojmë storien e juve. Në fakt, ju na keni kallxu neve storien e juve – rrëfimin për Kosovën – çka është e vërteta.”

Domethonë, gazetarët po na e pranojnë sot rolin që e kemi pasë si drejtus’ të kulturës. Po mendoj që kjo është veç një barrë që e kemi marrë prej gjeneratave t’kalume.

Qashtu jau ka bo edhe Fan Noli, Faik Konica, edhe shumë rilindas kur kanë fillu me shkru gazetari, edhe kur kanë fillu me bo gazeta – me kallxu që kemi gjuhën tonë, edhe kemi kulturë tonë, dhe që e kemi shumë të larmishme. Me kallxu që kemi krishterë, kemi myslimanë, kemi ortodoksë.

N’fund, gjuha për neve ka qenë qendrore – me e rujt gjuhën. Edhe qikjo ka qenë e natyrshme për neve. Nuk e kemi bo të sforcume – me i kallxu dikujt çka je ka qenë shumë e natyrshme, edhe diçka që tjerët – gjeneratat para nesh – na e kanë kallxu neve, e na i kemi kallxu tjerëve.

Noa Nikqi: Qysh mendoni që identiteti juve si gra – si shumë prej përkthyesëve që keni qenë gra – qysh ju kanë pa në terren? A keni hasë vështirësi prej kësaj?

Jeta Xharra: Është shumë interesant që dobësia jonë ka qenë përparësia jonë. E tash, dobësia-na e kanë pa si të parrezikshme. Shokët e mij – djem – policia i shihke si terroristë potencialë. Domethonë, bukalisht, pa e zbukuru, po du me t’kallxu që nëse ishe shqiptar – djalë i ri 18-19 vjeçar – i kishe dy probleme.

Problemi i parë ligjor ka qenë që me 18 vjet je dashtë me shku me e kry shërbimin ushtarak në ish-Jugosllavi. Edhe t’vetshin pse s’je rekrutu. Prej 90tave fillun me i ndjekë djemtë që i bonin 18 vjet – i kontrollojshin nëpër kafiq, ia kqyrshin letërnjoftimet. Edhe kur nuk ishin paraqitë për ushtri, jau dhezshin ka ni shuplakë neper kafiq – ku unë kom qenë vet prezente. S’po flas me të folë, po i kemi pa.

Kështu që, si djalë, ish qaj problemi i parë. I dyti: problemi fillojke n’97-98, kur veç u kriju UÇK-ja. Edhe çdo djalë i moshës madhore ata e konsiderojshin si rekrut për UÇK – edhe ai automatikisht ish “terrorist”.

Kështu që me shku në Drenicë – vendi ku ma së shumti shkojshim çdo ditë na me gazetarë qe punojshim si përkthyes – si djalë e kishe shumë ma shumë rrezik me kalu ka postblloku në Komoran qe ka qene. Postbllok famoz – i tmerrshëm – i mbushun me policë. Ku duhesh ti me folë me ta – gazetari folke, ti përkthejshe – po ata të shikojshin ty a je i rrezikshëm potencialisht, që je tu shku te këta të UÇK-së. Ni djalë e ka pasë shumë ma vështirë se unë.

Për qata, kolegu jem Fisnik Abrashi, që punojke me BBC-në gjithashtu si fixer, përkthyes – Fisniku rrike shumë ma shumë me e mbulu terrenin dhe montazhën n’Prishtinë. Sepse BBC-ja i thojke: “Ti je n’rrezik me të marrë ty me veti. Jeten ma lehte”

Edhe unë kom përfundu shumë ma shpesh në terren – për shkak që nuk më merrshin seriozisht, s’më merrshin si rrezik policia.

Njajtë muj me thonë ndoshta edhe UÇK-ja m’ka marrë pak ma... pak ma pak është frikësu. Sepse muj me thonë – duhet me e cekë – që na kemi qenë jo të mirëpritun gjithmonë prej UÇK-së. Edhe s’kanë pasë faj. Na kalojshim ka... na shkojshim me bo xhirime, edhe mandej me qato xhirime kalojshim ka serbët. Serbët lypëshin me pa kasetën: “Ama ta shoh kasetën.”Kuptohet që na e mshefshim kasetën që e xhirojshim UÇK-në, po UÇK-ja mendonte që na kena me i tërheqë serbët – forcat serbe – me ardhë me i faru ata, edhe katunin, kur na shkojshim n’qat vend dhe i xhirojshim ata.

Kështu që ka qenë ni fushatë me i bindë, me i folë, me i folë, e me i folë – sa t’besueshëm jemi na. Me i bindë për kredibilitetin edhe seriozitetin e punës. Sa seriozisht e merr ti punën, edhe që s’ke me i rreziku ata. Cilat janë masat që na i ndërmarim për mos me e rreziku UÇK-në.

Domethonë, edhe ndaj UÇK-së besoj që ka qenë ma lehtë me qenë çikë se me qenë djalë.

Noa Nikqi: A mendoni që është reflektu kjo edhe, për shembull, në Media Projektin që është marrë kryesisht me gra?

Jeta Xharra: Media Projekti është marrë me gra sepse e ka pa... e ka pa ni mungesë të hatashme të emancipimit të grave. Është shumë interesant që, fatkeqësisht, edhe sot ki organizatat rinore, organizata që merren kryesisht me emancipimin e grave. Unë po mendoj që na po vujmë për organizate për emancipimin e djemve.

Po është traditë me e kompenzu qat 500-vjetëshin apo historikisht patriarkalizmin. Media Projekti ka dashtë me e mujt patriarkalizmin edhe n'gazetari. Ka pa nevojë me mos u mshele gratë në shpija – gratë e gjeneratave të reja – mos me u mshelë nëpër shpija. Sepse, çka mbrijti Millosheviqi me bo, është me na kthy disa vjet mbrapa, mas disa avancimeve që i kish bo vendi jonë.

Në '70tat u formu Universiteti i Prishtinës. Kishin fillu gratë edhe me studiu, edhe me hi në punë. Gratë fillun me u qit prej pune – edhe gratë edhe burrat – po burrat i bonë qare diqysh. Fillun me u marrë me biznese private, me gjithatë burrat e kishin ni kafe ku dilshin, socializoheshin, lëvizshin diçka, fillun ndërmarrje të vogla, biznese t'vogla me çelë.

Gratë u kthyne në shpija. Gratë që ishin në shërbim civil deri atëherë, u kthyne në shpija. Domethonë, arriti – nanën teme sidomos – Milosheviqi arriti me e bo amvise. Ni gru që e kish kry fakultetin në juridik, kish punu në arsim prej momentit që kish diplomu si 28-vjeçare – kish punu 20 vjet në entin e arsimit – që ishte njëfarë ekuivalenti i Ministrisë së Arsimit... edhe u qit prej punes.

Nana jem, gru e emancipume, 10 vjet i kaloi në shpi. Ishte depresion – depresion për gra, ishte regresion për gra. Kështu që e di që n'shpinë tonë eshte ni regres social, jo veç regres politik. Domethonë, ka qenë regres social, me të shti me u kthy në shpi.

Edhe në terren, sipas Naxhies – nanës së Gjjerri Vules, për shembull – që merrej me aktivizmin e “Motrave Qiriazit”, organizatë që është marrë me luftimin e analfabetizmit në Kosovë në vitet '60, '70, '80, grua u aktivizu përmes Gjeraqina Vules, na u organizume, u mobilizune me bo aksione që çikat mos me mbetë në shpija.

Tash, për shkak se shkollat u kthynë në shpija u kthyne– domethonë, për shkak se nuk shkojshim ma në shkolla publike – filloi ni regres, ni arsyetim i ri që mos me e lonë çikën me shku në shkollë, në shpi të dikujt që s'e njifshe. Kjo, në zona rurale, filloi me ndodhë. Edhe na – qikjo organizatë “Media Projekti”, mes tjerash – na mobilizojke neve, çikave 15-vjeçare, me shku me folë me çika tjera t'reja, me vazhdu me shku në shkollë.

Domethonë, e ka pase, gjithmonë gazetaria jonë ka qenë – gazetaria që e kemi zhvillu, edhe sot gazetaria që e zhvilloj – ka qenë, po du me e qujtë, aktive apo “*engaged journalism*”. Nuk ka qenë veç raportim i thjeshtë. Kurrë nuk ka qenë raportim i thjeshtë, sepse ka qenë njëfarë detyre rilindase, kështu me thanë, ideologjia ka qenë rilindase – që ti ekziston për me ja qelë sytë njerëzve. Nuk është veç informim i thjeshtë.

Për shembull, BBC-ja me t'cilën punojsha, e kish informimin e thjeshtë – e kryjke punën, e konsiderojke që institucionet tjera kanë me u mobilizu bazu ne informacionin e dhanë.

Na e kishim t'qartë që institucionet tjera nuk mobilizohen. Ti duhesh me bo presion mbi institucionet tjera – në atë kohë n'edukim, mandej në organizatat ndërkombëtare.

Sot, une e kom – si me thanë – gazetaria që e zhvilloj bashkë me 70 kolegë bon presion n'institucionin e drejtësisë. Na nuk e kryjmë punën në momentin që e qesim një hulumtim. Na i shkrujmë 300 letra në vit institucioneve ligjore, prej t'cilave arrijmë dikun 50 impakte me gazetarinë tonë: ose njerëz që i ekspozojmë janë në procese disiplinore, ose qiten prej punes, ose arrestohen, ose ndonjë proces institucional që është tu ndodhë ndrron si rezultat i gazetarisë të angazhuar apo aktive që e zhvillojmë. Edhe qikjo vjen – unë mendoj – prej asaj të '90tave, që kurrë s'jemi mbështetë që tjerët e kryjnë punën e vet nëse ti veç raporton.

Dimensioni kryesor i punës tonë ka qenë në fuqizimin e një gjenerate, e cila – ndoshta mendohet që na jemi mbështetë në prindërit tonë – po prindët tonë fillun me u mbështetë n'neve. Pse? Sepse na fillum- është shumë me randësi elementi ekonomik, qe prindët tonë ishin qitë prej pune edhe ishin pa pare. E na fillum me u marrë me përkthim drejt, nëse dojmë me qenë të drejtë – edhe për shkak se prindët tonë as semestrin e fakultetit s'mbrijsin me na e pagu.

U pa prej fillimit që, nëse dojmë me studiu, nëse dojmë me jetu, na prej fillimit duhet me i bo paret tona. Ka qenë presion i madh ekonomik në gjeneratën tem – me fitu sepse prindët tanë nuk fitojshin, ishin dale prej pune. Kjo ka qenë një.

Fakti që na arritëm me fitu ma shumë se prindët tonë, ke një ndrrim komplet i varësisë nëpër shpija. Plus me faktin që na ishim çika që po fitojmë ma shumë se baba jonë.

Kogja është – domethonë – ndrrim i çdo klisheje që kish ekzistuar deri atëherë, edhe në familje intelektuale. Sepse duhet me e pranuar – edhe familjet intelektuale ishin patriarkale. Me gjithatë, intelektuale – u mendojshin me e paraqitë veten intelektuale – po në relacion me çika, relacioni me çika ish: “Derisa je nën kulm temin, bon çka t'thom unë. Vesh çka t'thom unë. Frajerat s'ka me e zgjedhë bash kon don ti, po frajerin u duhke me ta aprovu familja.”

Domethonë, krejt qijo – dikun me 30-50 veta të gjeneratës tem' – ndrron kur babat tonë, le mo nanat, fillun m'u mbështetë në neve për mbijetesë.

Nuk është ky element me u lanë anash. Edhe na nuk u lazdrum për shkak t'asaj pune – po na e marrëm k'te shumë seriozisht.

Për shembull, une e di që kjo ka reflektuar në faktin që unë kom dashtë menjëherë – paret e para që i kom fitu i kom shti me e msu nanën teme anglisht. Edhe çka ma kujtohet, është që kur e fillova – për shembull – është elementi që kur fillova me studiu, '96-ta ish, e regjistrova dramaturgjinë. Edhe dramaturgjia ish me shkrujt drama. Mu m'vyjke kompjuter. Unë e shihsha që s'kom me mujtë sen me bo pa kompjuter. E kompjuteri nuk ish pjesë e çdo shpije. As llaptopi, llaptopi jo se jo. Po kompjuteri shumë organizata e zyre të caktume e kishin kompjuter. Nëse e kishe kompjuterin, mujshe me u lidhë me internet. Domethonë, as telefona mobilë s'kishim. Kompjuteri ish teknologjia e fundit.

Unë bona presion të madh te prindët e mi me ma ble ni kompjuter. Ata s'kishin pare. Nana jem vendosi me i shite pesë lira që ia kishin dhonë në martesë. E nxorri prej çelësit edhe ma blejti kompjuterin e parë. Kjo osht' në '96ten.

Edhe prej atëhersh, qaq ja di për nder, sepse tha – me debatin e madh që e patëm në shpi – i thashë: “Çka pi rrun ti këto sene? Unë s'du me u martu kurrë.”

Parameno! I kom thonë: “S'du me u martu kurrë.” Edhe sot e kësaj dite s'jom martu. Thashë: “Çka po i rrun?” S'kom pasë mend me u martu. Mend s'kom pasë te martesë. Thash “Qat çelës që je tu e bo, s'di për kon je tu e bo, se martesë s'është me rëndësi për mu. Per mu Unë po du me shkrujt.”

Edhe nanës ja nisi- tu m'ndëgju mu në biseda që i zhvillum- me i ndërru mendja. Edhe tha: “Okej, i kom edhe pesë lira që i kom rujt për ty, me t'i dhanë, po i shesim.” I shitëm. Treqind marka – pesë lira – edhe e blemë kompjuterin.

'98-ën, kur une mbledha boll pare, seni i parë që e bona ish me ia kthy nanës në një farë mënyre. Ajo kish investu n'edukimin tem. Unë i ndihmova me shku në kurs të anglishtes.

Ajo dojke mu m'su n'kurs t'anglishtes, sepse une u bijsha shumë gazetarë n'shtëpi, edhe ajo e pa nevojën mu – që s'mjafton veç me ditë juridikun, shqipen, serbishten, që i kish ditë – që e ardhmja është anglisht. Edhe filloi me mësu anglishten. Edhe thojke: “S'po muj me besu që-” kjo ka ndodhë ose '98, ose '99 ”që ti po ma pagun mu shkollimin.”

Ishte një dinamikë interesante. Domethonë, kjo dinamikë shoqnore është shumë me randësi. Qiky moment për mu osht indikativ – çka munden me bo nanat edhe familjet, kur përkrahin ni ambicie, te dikush- ni çikë e re.

Ka mujt nana me thanë: “Na vijnë pesë lira.” Sot, për shembull, shumë njerëz vazhdojnë me investu në shtëpia të mëdhaja, në kate të mëdhaja, e shumë pak në edukim – ose në telefon të shtrejtë, në kerr të shtrejtë – shumë pak në edukim. Mendoj që qajo e bën dallimin mes asaj çka po duam me qenë: njerëz që duken “bling-bling”, që shkëlqejnë, që kanë ari rrethepërqark ose botoksa... Apo dojmë me qenë t'informum edhe me i pasë sytë qelë.

Prindët e mi, mendoj që kanë lujtë rol të hatashëm – tu ma shti n'kry Migjenin, me tetë vjet, me e mësu Poemën e Mjërimit – dhe mandej tu, mes tjerash, kështu me thanë, “qershija në torte” ka qenë nana me e shitë pesëmijëshin për me ma ble mu kompjuterin.

Noa Nikqi: Qysh e keni mësu ju anglishten?

Jeta Xharra: Insistimi i prindëve, prej klasës tetë me shku në kurs të anglishtes.

Domethonë, prej asaj kohe të '90tave është me randësi me ditë që na jemi bo njerëz t'shkathët dhe ma t'gjindshëm – për shkak te krejt aktiviteteve që i kemi bo që kanë qenë jashtëshkollore: shkruarja n'gazeta, shkruarja n'kurse të ndryshme, kurse të anglishtes.

Prindët tonë kanë insistu na me... U pa në '90tat që shkolla është shumë e dobët. Edhe që kjo shkolla-shpija – okej, ishte ruajtje e identitetit tand – por shkolla-shpija nuk msojshim. Duhet me pranë që shkollat-shpija nuk t'përgatitshin ty për një treg pune.

Deri në qatë masë, kur kam shku me bo master, unë jom dashtë me kompenzu – tu mësu prej librave t'shkollave të mesme në Angli – me mbushë një farë kulture të përgjithshme për historinë botënore që s'e kisha- që s'e kisha pasë, tu shku n'shkolla-shpia ktu. Edhe shkumja në kurse, mes tjerash, një gja që mendoj menjëherë – që sot ia rekomandoj çdo çike, pa marrë parasysh n'çfarë kohe je – është me e kry vozitjen, me e kry kursin e vozitjes. Sepse njeri që vozitke, në profesionin tem u pagujke ma mirë se njeri që nuk e kish lejen e kerrit.

Edhe si i kom bo tetëmbëdhjetë vjet, kom fillu me i majtë orët edhe mandej m'u ka dashtë me mësu me vozitë edhe *Land Rovera*. *Land Roveri* është pak ma i rëndë si kerr – kur po thom *Land Rovera*, kerr i blindum – sepse ishin kerret që i vozitshim. Edhe njonin prej ktyne kerreve të blindume e kemi pensionu tash në Prishtinë. E kemi marrë prej Anglisë, kerri i cili ka vozitë nëpër Drenicë, BBC-në e ka vozitë dy vjet, është sot në Kosovë.

Me e vozit qat kerr ka qenë një fuqizim tjetër fizik që je dashtë me bo. Krejt po i thom këto elemente: vozitja, gjuha, shkrimi, kontakti me të huaj, që me gjuhë na u qelën dyrt edhe kishim mundësi me mësu prej ma të mirëve. Sepse nëse kishim ditë veç shqip, po, mësojshim prej njerëzve që i kishin shkathtësitë e raportimit t'Medies në Kosovë. Neve, masi krejt gjeneraten na kanë shti prind me mësu anglisht, mes tjerash kemi ndigju muzikë veç anglisht. Kemi ndigju, edhe jemi marrë shumë me- kemi analizu tekstet anglisht. Kjo na ka shti me pasë qasje në njerëz të cilët në Angli shumë rrallë mrrijnë dikush që diplomon me bo punën që e bojmë na: qe osht n'praktikë, me dalë në terren me njerëz ma të mirë të profesionit të vet.

Domethonë, ke pasë gazetarë të *Washington Post*-it, *New York Times*-it, *BBC*-së, të cilët thojshin: “Hajde edhe ti – je përkthyes – m'ndëgjon mu”, edhe nëse një vjet e kalon në terren, veç budallë mu kon qe mos me mësu ti kurgjo.

E shihshe qysh folin me njerëz të thjeshtë edhe me njerëz të komplikum, edhe qysh i zbusin palët që e kanë vështirë me folë me ta – qysh komunikojnë me ta. Qikjo ka qenë roli jonë, edhe u mësum me u sjellë shumë herët si njerëz të pjekun – ma të pjekun se mosha jonë.

Domethonë, kufomat e para mbërrij me i pa me nëntëmbëdhjetë vjet. Kufoma të shumta ka 50 kufoma– gra e fëmijë... gra e femije. Prej teenagerave, që kurrë s'kishim shku në katun, u bome teenagera që u duhshim me majtë barrën e kallëzimit të stories së këtyne trupave. Edhe rrëfimit- përmes familjarëve të tyne ti u duhshme me e reflektu qata që po ndodh.

Shumë shpesh, ai elementi tjetër – për shembull me UÇK-në – ka qenë elementi që UÇK-ja i ka pasë dy gjana n'të cilat mendoj që kemi ndiku përmes gazetarëve të huaj – edhe na – me i ndërru. Edhe kanë qenë gjana simbolike, të randësishme.

Një ka qene me hekë maskën. Sepse u dukshin si terrorista. Edhe na folshim me ta që: “Po dukeni si terroristat e Etës në Spanjë. Nuk kemi me marrë simpatinë e botës nëse vazhdon me bo intervistën me maskë.” Menjëherë patëm ndikim pozitiv. UÇK-ja e heki maskën. Kjo ish një.

Dy: e kishin një përshëndetje komuniste, partizane – qishtu me grusht. Edhe ata, përmes gazetarëve të huaj, e kuptun që kjo ka me lanë shenjë të keqe – shenjë te guerilve t’majtë që nuk janë të interesum n’demokraci e Perëndim, po janë të interesum për një socializëm, totalitarizëm, edhe majtizëm lindor, e jo perëndimor.

Ky ish njëfare element që nuk e fitojke simpatinë në botë – edhe ky element u hek, përmes bisedave që i kemi bo, edhe si përkthyste, me guximin që na e jepshin gazetarët, po edhe me afërsinë që e krijum me qita ushtarë në terren.

Qito janë elemente që mendoj kanë qenë të vogla – tash, varësisht qysh t’dush me i interpretu – të vogla ose të mëdhaja, po çdo element atëherë ka qenë pjesë e solidaritetit kolektiv tonë, edhe sakrificës t’vogël civile që secili e ka bo.

Gratë kanë qenë në protesta të ndryshme. Nëse vjen te *Reporting House*, i kemi kushtu vëmendje të posaçme protestave me bukë që i kanë bo gratë. Edhe ajo është një element i rëndësishëm i '90tave, sepse është shumë autentike. Parameno: dy javë masi që ndodh – dy-tri javë masi që ndodh masakra e Jasharëve – nuk shkojnë konvojet humanitare, s’ka bukë në Drenicë. Gratë vendosin rolin privat që e kishin n’shpi e që ishte me bo bukë, e çojnë n’rol publik, marrin bukë prej furrave dhe n’mënyrë simbolike, mijëra gra nisen prej Prishtinës, n’Prekaz me shku me bukë n’dorë, është i njohur protesta me bukë. Edhe pse po thom është e rrallë, sepse kurrë mo s’osht përsërit. Kërkund në botë nuk u përsërit protesta me bukë.

E dallon Kosovën qajo periudhë e 90tave, ku na nuk kemi kalu drejt prej – se ish Jugosllavia, ish Republika e Jugosllavisë – ka kalu prej “Vëllaznim-bashkimi” drejt në vrasje të njoni-tjetrit. Ne e kemi pasur një periudhë të rezistencës civile, ku jemi mundu me tërheqë vëmendjen me qito aktivizma, me qito metoda aktiviste, e qito kanë qenë- qito gra që i kanë zhvillu qito protesta, qekjo frymë kanë qenë mësueset tona. Edhe na si fikserë, përkthyste na u ka dukë vazhdimësi e qasaj që kemi pa tu bo rezistenca paqësore, njëherë pasive masnej aktive, që rezultoi masnej në rezistencë t’armatosur dhe në sjelljen e bombardimit t’NATO’s.

Noa Nikqi: A mendoni që roli juve si fixer është njëjtë një formë e rezistencës, po ndoshta më pak që ka qenë i njohur në qat kohë?

Jeta Xharra: Po, më pak ka qenë i njohur, sepse na jemi njerëz t’cilët “by default”, ose si natyrë e punës, e përfshijmeë nën vete të qenurit modestë dhe në prapavijë. Edhe na kurrë s’jemi imponu, edhe kemi bo mirë. Unë mendoj qe kemi bo mirë. Sepse nënteksti e kallxon rrëfimin e vet. Nënteksti është që bombardimet kanë ndodhë – krejt prej të cilit janë fry mas luftës, sot jon pishman. Na nuk kemi naj sen për të cilin jemi pishman, mendoj n’përgjithësi, si njerëz që kemi qenë përkthysë, të gjithë i kemi gra punëve dhe karrierës mas lufte, pa u fry ca kena bo n’luftë.

Unë e preferoj qeta sesa me qenë, me u fry edhe me “Un un un un”. N’fund Kosova mas lufte nuk ka lulëzu – qysh kena me thanë që ka lulëzu. Apo jemi mbrapa nga ish Republikat e

Jugosllavisë, atëherë pe kuptojmë pse jemi mbrapa: kemi qenë mbrapa, se tjerët na kanë udhëheq. Beogradi na paska udhëheq. Krejt Republikat kanë pas kanalizim, ujë dhe zhvillim ma shumë se na. Sot prapë jemi të fundit, e po bohen gati tridhjetë vjet që na i kemi pune dorë.

Domethonë, na ndihemi – na ndihemi, si njerëz që nuk jemi t'kënaqun. Shumica prej nesh, sa i njej, nuk jemi të kënaqun me zhvillimin e Kosovës. Prandaj, ne s'dojmë fort me u fry me çlirimin e Kosovës, se luftë e madhe, sakrificë e madhe – e kena pa me sytë e mi u bo prej qatyne njerëzve që i kemi mbulu. Njerëz janë vra. Edhe na vjen keq. Unë, me bisedat që kam bo me krejt – me fikserat e asaj kohe – neve-na e kena ni ndjenjë të keqardhjes qe s'kena mujtë me bo ma shumë. Edhe mas lufte mendojmë që krejt Kosova osht dasht me bo ma shumë.

Ne s'kemi vend këtu m'u krekos edhe m'u fry. Mirë është m'u ditë kontributi jonë, por na jemi pagu për qata që kemi bo, edhe jemi zhvillu profesionalisht për qata që e kemi bo. Nuk o' që nuk ia kemi pa hajrin kontaktit që e kemi pasë me gazetarë të huaj. Na ka shërby me u bo profesionistë ma të mirë sot. Shoqënia jonë ia ka pa hairin edhe profesionalizmit tonë. Qikaq, s'ka nevojë me u bo statuja n'emër tonë – po është mirë gazetaria me u zhvillu t'u u mbështetë në disa vlera që i kemi pa atëherë te gazetarët profesionalë.

Unë mendoj që qajo osht fryma të cilën po e përcjellim – dikush si akademik, n'studenta t'vet, unë nëpër gazetarë si redaktore e tyne dhe udhëheqëse e një organizate mediatike – dhe po i përgatisim tjerët per beteja t'gjeneratave t'ardhshmë – edhe ata me siguri kanë me thanë për neve çka kena thonë na për tjerët, që “s'e keni bo namin”. Qashtu ka qenë qasja që na e kena pasë ndaj gjeneratës kalume.

Kështu që s'po pres... nuk jemi njerëz që jemi fort t'ofendum, muj me thanë për... sa pak përmendem, s'kemi qenë n'qendër të vëmendjes. Nuk e kena bo për me qenë n'qendër të vëmendjes. E kemi bo për me mbërri deri te çlirimi i Kosovës.

Edhe... nuk osht kry puna hala. Mendojmë që nuk osht kry puna hala.

Noa Nikqi: Nese nuk keni diçka me shtu-

Jeta Xharra: Kur po thom nuk osht kry puna hala, nuk e kom fjalën për çlirim, po për bomjen e Kosovës vend të drejtë – vend të drejtë edhe të barabartë për krejt me jetu. Bomjen e Kosovës një vend ku s'ki nevojë me dalë jashtë për me e realizu veten.

Qikjo po mendojmë – unë mendoj për veti që kemi hala punë me bo.